



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Edi Peloka inkriminon veten: Manipulova votat për zgjedhjen e Bashës kryetar të PD-së! (Tërhiqet nga lëvizja e Berishës?)
- 2

25 vite nga dhuna ndaj Edi Ramës! Gazetat e kohës: Goditet për vdekje nga falangat e pushtetit të PD! Ishte zhveshur, vrasësi: lu hoqën tutat kur po e tërhiqja zvarrë
- 3

Mbyti me duar krushkën se i kishte borxhe, lihet në burg 58-vjeçar! 63-vjeçarja u gjet gjysmë e zhveshur, vrasësi: lu hoqën tutat kur po e tërhiqja zvarrë
- 4

'Ishte diçka e shpifur', Stresi komentoi lidhjen Donald-Beatrix: Komentoi në foton e Bores, realiteti i hidhur
- 5

'Më përdhuni edhe shpirtin, jo vetëm trupin'/ Prifti në Greqi abuzoi 7 herë me shqiptarën brenda në kishë! Filmi që i dha forcë të mitures për të treguar

Kronikë

Merrte makina me qira dhe i kthente në pjesë këmbimi, arrestohet i riu në Berat! Policia i gjen edhe një pistoletë! Një kallashnikov gjendet në lagjen 'Çlirim'

Të dy armët e zjarrit të sekuestruara do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekzaminime të mëtejshme, pasi dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.



Arma e sekuestruar nga policia

[Sh]

Redaksia

18 Janar, 10:07 | Përditësimi i fundit: 18 Janar, 10:21



Një i ri ka rënë në prangat e policisë së Beratit pasi ishte shpallur në kërkim më herët për mashttrim. Endri Koraqe mësohet se merrte makina me qira dhe nuk i dorëzonte më, pasi i kthente në pjesë këmbimi ose i braktiste në rrugë.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia pranë banesës së tij, u gjet dhe një armë zjarri pistoletë, e cila i përkiste të riut.

[Sh]

.com

LEXO EDHE:

Mbyti me duar krushkën se i kishte borxhe, lihet në burg 58-vjeçar! 63-vjeçarja u gjet gjysmë e zhveshur, vrasësi: lu hoqën tutat kur po e tërhiqja zvarrë

Sakaq, gjatë kontrollit të territorit, në lagjen 'Çlirim' policia gjeti të fshehur edhe një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak ndërsa po punohet për identifikimin dhe kapjen e poseduesit të saj.

Të dy armët e zjarrit të sekuestruara do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekzaminime të mëtejshme, pasi dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.

Njoftimi i Policisë
Finalizohet operacioni policor i koduar "Osumi". I shpallur në kërkim për mashttrim, nga 4 Drejtori Vendore të Policisë, kapet dhe ndalohet 30-vjeçari, i cili posedonte dhe një armë zjarri pistoletë. Gjithashtu, shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit të territorit, gjetën të fshehur edhe një armë zjarri kallashnikov. Punohet për identifikimin dhe kapjen e poseduesit të saj.

Të dy armët e zjarrit të sekuestruara do të dërgohen në Institutin e Policisë Shkencore, për ekzaminime të mëtejshme, pasi dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.

Në vijim të kontrolleve të ushtruara në territor, me qëllim kapjen dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të shtetasve të shpallur në kërkim, atyre që qarkullojnë me armë zjarri apo me lëndë narkotike, nga specialistët e Seksionit për Krimet në Komisariatin e Policisë Kuçovë, pas informacioneve për vendndodhjen e një shtetasi të shpallur në kërkim, i cili posedonte dhe armë zjarri, u organizua dhe finalizua operacioni "Osumi", për kapjen e këtij shtetasi.

Si rezultat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale në Policinë e Shtetit, Forcat Operacionale të DVP Berat dhe shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kuçovë u bë i mundur lokalizimi dhe kapja e shtetasit:

E. K., 30 vjeç, banues në lagjen "11 Shkurti", Kuçovë, i shpallur në kërkim nga Komisariami i Policisë Kuçovë, Komisariami i Policisë Durrës, Komisariami i Policisë Nr. 6 Tiranë dhe DVP Lezhë, për veprën penale "Mashtrimi".

Ky shtetas merrte makina me qira dhe nuk i dorëzonte më, pasi i kthente në pjesë këmbimi ose i braktiste në rrugë. Nga kontrolli i ushtruar, shërbimet e Policisë gjetën të fshehur në afërsi të banesës së këtij shtetasi, në Kuçovë, një armë zjarri pistoletë, e cila gjatë hetimeve të para hetimore rezultoi se i përkiste 30-vjeçarit.

Gjithashtu, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Berat, në vijim të kontrollit të territorit dhe informacioneve të marra në rrugë operative, në lagjen "Çlirim", gjetën të fshehur një armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak. Vijn puna për identifikimin dhe kapjen e poseduesit të kallashnikovit. Materialet janë referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, për veprime të mëtejshme.

M.Ç/Shqiptarja.com

TAG: [Berat](#) [Arrestime](#) [policia berat](#)

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

.com

Sondazhi i ditës:

Përçarja e PD mes Berishës dhe Bashës, mendoni se garanton fitoren e PS në 6 bashkitë?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Kronikë

I dënuar në Itali me 10 vite burg për tentativë vrasje, arrestohet në Tiranë 34-vjeçari

22 Janar, 10:59

Kronikë

Sekuestrohen 2 laboratorë prodhimi Bitcoin me vlerë 1 mln euro në Shijak, 3 në pranga dhe 4 në kërkim! Surprizojnë shqiptarët, nga vjedhja e energjisë 'evoluojnë' te panelet diellore

22 Janar, 10:22

Kronikë

'Luftë' lojërave të fatit në Berat, goditen 4 raste, nën hetim 4 pronarë lokalesh

22 Janar, 10:00

Kronikë

Aksidenti për vdekje 83-vjeçarin dhe më pas e hodhi në kanal për të fshehur ngjarjen, arrestohet pas 10 ditësh 48-vjeçari në Elbasan

22 Janar, 09:20

Kronikë

U përfshi në aksident dhe goditi me sende të forta shefin e 'Rrugores', arrestohet 70-vjeçari në Berat! Në shtëpi i gjendet një pistoletë

21 Janar, 14:52

Kronikë

Dhunoi bashkëjetuesen, arrestohet 20-vjeçari në Durrës! Në pranga edhe një tjetër i shpallur në kërkim

21 Janar, 14:37

Kronikë

DOSJA/ 5 episodet ku u kapën 219 klandestinë! Përgjimet që fundosën trafikantët e refugjatëve nga Lindja e Mesme përmes Shqipërisë drejt Italisë e Greqisë: Nxirri lekët, t'ju çojmë në Tiranë

21 Janar, 13:25

Kronikë

Kapet me automatik, arrestohet i riu në Tiranë, ja çfarë i gjeti tjetër policia

21 Janar, 12:13

Kronikë

Grabiti para, veshje dhe ushqime në 3 biznese, arrestohet 20-vjeçari në Pogradec

21 Janar, 11:17

Kronikë

Vrasja në Kuçovë, reagojnë të afërmit e viktimës: Autori është gjysmak dhe budalla, s'ka pasur kurrë familje

21 Janar, 10:48

Kronikë

Ngriti shtëpi bari bashkë me tre shokët në Lushnjë, pas një viti në kërkim arrestohet 32-vjeçari

21 Janar, 10:05

Kronikë

Kuçovë, komshiu mbyti 64-vjeçaren dhe e hedh trupin në kanal! Gruaja u gjet gjysmë e zhveshur dhe e mbuluar me gjethe! Shkak konfliktet për borxhet, autori: Më ngeli në dorë, se kuptova si vdiq

21 Janar, 07:00

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

[Shqiptarja.com]

Kërko

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje